

Datë: 12.05.2026
Për: Kuvendin e Komunës së Shtimes, kryesuesit të Kuvendit dhe anëtarëve të Kuvendit;
Nga: Rrahman Hysenaj, rruga "Ymer Devetaku" nr. 8, Shtime Tel: 044 908 828.
Lënda: Kërkesë për ndërtimin dhe rregullimin urgjent të kanalizimit fekal

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Shtimes,

Përmes kësaj kërkesë, ju drejtohem që Kuvendi i Komunës së Shtimes të shqyrtojë dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ndërtimin dhe rregullimin e kanalizimit fekal në rrugën "Ymer Devetaku", duke filluar nga hyrja deri në përfundim të kësaj rruge.

Aktualisht, kjo rrugë aktualisht është duke u ballafaquar me sistem jo funksional të kanalizimit fekal, gjë që paraqet problem serioz për banorët e kësaj zone. Mungesa e kanalizimit ka krijuar kushte të papërshtatshme higjieno-sanitare, duke rrezikuar drejtpërdrejt shëndetin e banorëve, sidomos të fëmijëve dhe të moshuarve. Ujërat fekalë, në mungesë të rrjetit adekuat, mund të depërtojnë në tokë dhe të kontaminojnë ambientin, duke shkaktuar ndotje të tokës, ujërave nëntokësore dhe duke krijuar rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektive.

Po ashtu, mungesa e kanalizimit mund të shkaktojë dëme materiale në pronat e banorëve, përfshirë dëmtimin e themeleve të objekteve, përmbytje të oborreve dhe përkeqësim të kushteve të jetesës. Kjo situatë cenon drejtpërdrejt mirëqenien, sigurinë dhe dinjitetin e banorëve të kësaj rruge.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projekti për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, kërkoj që Kuvendi i Komunës të trajtojë këtë çështje me prioritet dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për përfshirjen e këtij projekti në planifikimet dhe investimet komunale.

Shpresoj në mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj për zgjidhjen e këtij problemi jetik për banorët e kësaj zone.

Rrahman Hysenaj

